

PËRMBLEDHJE E PANAIRIT TË USHQIMIT, PIJEVE DHE AGROTURIZMIT AGROKOS 2025



27-28 Maj 2025

Salla 1 Tetori - Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E INDUSTRIE,
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË



KIESA

Organizator: CEO – Congress and Event Organization



Me sukses të jashtëzakonshme është përmbyllur edicioni i 25-të jubilar i Panairit Ndërkombëtar të Agrobiznesit, Ushqimit , pijeve dhe Agroturizmit – AGROKOS 2025, ngjarja më e madhe e këtij sektori në Republikën e Kosovës.

I zhvilluar më 27 dhe 28 maj 2025, në Sallën “1 Tetori” në Prishtinë, ky panairi shërbeje edhe këtë herë si ngjarja kryesore më e madhe kombëtare e bashkëpunimit ndërsektorial, inovacionit rural dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Për dy ditë me radhë, mijëra vizitorë patën mundësinë të përjetojnë një ngjarje te veçantë ku bujqësia, agroturizmi dhe teknologjia e re u ndërthurën në funksion të zhvillimit kombëtar dhe bashkëpunimit rajonal.



Një rol të rëndësishëm në këtë panair pati Agjencia Kosovare për Investime dhe Enterprise (KIESA), në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), e cila përkrahu pjesëmarrjen e rreth 30 prodhuesve vendorë. Synimi kryesor i kësaj përkrahjeje ishte promovimi i produkteve vendore, nxitja e bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë dhe forcimi i zhvillimit të agroturizmit në Kosovë.

Agrokos është mbështetur nga



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E INDUSTRISE,
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

KOSOVO
INVESTMENT
AND ENTERPRISE
SUPPORT AGENCY

KIESA



Ky edicion jubilar solli bashkë pjesëmarrës nga të gjitha hallkat e zinxhirit të vlerës, si: fermerë, përpunues ushqimorë, sipërmarrës të turizmit rural, kompani të makinerive bujqësore, prodhues të pijeve artizanale dhe institucione vendore e ndërkombëtare që mbështesin sektorin.

Panairi u dëshmuar si platforma më e rëndësishme e vitit për promovimin e produkteve vendore, krijimin e mundësive të reja për eksport, nxitjen e sipërmarrjes femërore dhe zhvillimin e modeleve të qëndrueshme të turizmit rural.

CEREMONIA E HAPJES



Hapja zyrtare e edicionit të 25-të të Panairit Ndërkombëtar AGROKOS & AGROTURIZËM 2025 u bë nga Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, së bashku me Ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Rozeta Hajdari.

Ky panair organizohet nga kompania CEO, ndërsa këtë edicion është mbështetur nga KIESA, e cila ka përkrahur rreth 30 prodhues. Synimi kryesor i kësaj përkrahjeje ishte promovimi i produkteve vendore, nxitja e bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë dhe forcimi i zhvillimit të agroturizmit në Kosovë



z. Albin Kurti
Kryeministri i Republikës së Kosovës

Për herë të parë, janë ndarë 300 milionë euro për 120 mijë fermerë përmes granteve dhe subvencioneve, me ç'rast mbështetja për grurin është rritur me 275%, e për bujqësinë organike me 500%. Janë rehabilituar sisteme ujitjeje për mbi 11 mijë hektarë dhe është rritur për 50% toka e punueshme bujqësore për vetëm katër vjet – nga rreth 80 mijë hektarë në mbi 120 mijë hektarë. Prodhimi vendor dhe konkurrueshmëria e produkteve tona në tregje të huaja është rritur.

Nga viti 2019 deri më sot, eksporti i domateve, zarzavateve dhe perimeve të konservuara është shumëfishuar. Në blegtori kemi ndarë mbi 13 milionë euro për ndërtimin e 93 stallave të reja, shtimin e mbi 2,000 krerëve gjedhe dhe blerjen e dhjetëra traktorëve.

Për herë të parë janë kthyer në pronësi të shtetit prona me vlerë miliona euro, të cilat më parë ishin tjetërsuar në mënyrë të paligjshme. Kemi kthyer besimin te ligji, te drejtësia dhe te mbrojtja e pasurisë publike. 30 mijë fermerë në baza vjetore janë dëshmitarë përfitues të angazhimit të ministrisë dhe qeverisë në përgjithësi.



znj. Rozeta Hajdari
Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Mbështetja nga Agjencia KIESA, gjatë tri viteve të fundit, ka mundësuar pjesëmarrjen e rreth 500 bizneseve në promovimin e produkteve vendore në panaire ndërkombëtare, prej tyre 33 panaire të industrisë së ushqimit dhe pijeve.”

“Krijimi i lidhjeve midis investitorëve dhe ndërmarrjeve mikro, të vogla, të mesme dhe ndërmarrjeve ‘start-up’ me shumë potencial të pasqyruar dhe ide kreative që presin të bëhen realitet, është një investim për të ardhmen e ndritur të Kosovës.”

“Inkurajoj ndërmarrësit vendor që të marrin pjesë në sa më shumë panaire vendore dhe ndërkombëtare, të krijojnë lidhje me biznese dhe investitorë nga diaspora dhe të huaj, si një rrugë efektive për forcimin e aftësive konkurruese dhe integrimin në zinxhirët ndërkombëtarë të vlerës.

VIZITAT NE STENDA TE BIZNESEVE DHE ATMOSFERA E PANAIRIT



Përgjatë dy ditëve të panairit, Salla “1 Tetori” u mbush me gjallëri, energji dhe frymë bashkëpunimi. Vizitorë nga e gjithë Kosova dhe rajoni, përfaqësues institucionesh, biznesesh, fermerë, studentë dhe qytetarë të zakonshëm shëtitën mes stendave për të parë nga afër produktet dhe shërbimet që ofruan ekspozuesit.

Çdo stendë ishte një tregues i pasurisë bujqësore dhe potencialit të agroturizmit në Kosovë dhe rajon. **Grupet kryesore të produkteve dhe shërbimeve të ekspozuara ishin:**

➤ PRODUKTE BIO DHE TË CERTIFIKUARA

➤ PAKETIME DHE ZGJIDHJE PËR PËRPUNIMIN E USHQIMIT

➤ MAKINERI DHE TEKNOLOGJI BUJQËSORE MODERNE

➤ PIJE ARTIZANALE DHE PRODHIME TRADICIONALE

➤ OFERTA PËR TURIZËM RURAL DHE MIKPRTJE AUTENTIKE NË FSHATRA TURISTIKE

Atmosfera ishte e mbushur me aroma karakteristike të produkteve vendore, degustime, shfaqje demonstrative të pajisjeve dhe prezantime interaktive nga kompanitë pjesëmarrëse.

Panairi u shndërrua në një platformë reale B2B, ku u zhvilluan takime mes prodhuesve, përpunuesve, ofruesve të shërbimeve dhe blerësve potencialë, duke krijuar rrugë të reja bashkëpunimi dhe marrëveshesh tregtare.



AKTIVITETET PARALELE



Panairi AGROKOS & AGROTURIZËM 2025 nuk ishte vetëm një ngjarje ekspozuese, por edhe një laborator i gjallë i ideve dhe bashkëpunimit praktik, falë aktiviteteve dhe paneleve të shumta të organizuara gjatë dy ditëve të panairit.

Panelet Diskutuese

Paneli: Zhvillimi i agroturizmit si motor i ekonomisë lokale

Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Qeveria e Kosovës, organizata ndërkombëtare, Odat Ekonomike dhe operatorë turistikë ruralë. U diskutua mbi potencialin e agroturizmit për të krijuar vende pune, fuqizimin e grave në sipërmarrje dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore përmes turizmit rural.

Paneli: Inovacioni në agrobiznes dhe transformimi digjital

Përfaqësues të kompanive të teknologjisë bujqësore prezantuan zgjidhjet më të fundit për mekanizimin modern, monitorimin digjital të fermave dhe praktikatat e qëndrueshme për bujqësinë.

Prezantime dhe Projekte

Prezantim: Mundësitë e bursave dhe trajnimeve për sipërmarrësit ruralë

U prezantuan programe të mbështetura nga donatorë ndërkombëtarë dhe institucione vendore që ofrojnë bursa dhe trajnime për të rinjtë dhe gratë e angazhuara në agrobiznes dhe agroturizëm.

Lansimi i projekteve të reja për zhvillimin rural

Gjatë panairit u promovuan disa projekte të reja për modernizimin e fermave, krijimin e qendrave të pritjes turistike në zonat rurale dhe përforsimin e zinxhirëve të vlerës së prodhimeve bujqësore.

PËRSHTYPJET E EKSPOZUESEVE PËR PANAIRIN AGROKOS



”

Përshtypjet e para nga dita e parë kanë qenë shumë të mira. Ka pasur mjaftueshëm vizitorë dhe kemi takuar përfaqësues të disa kompanive me të cilat bashkëpunojmë prej vitesh, si nga Kroacia ashtu edhe nga Italia.

Z. Hasan Abazi
AgroFierence

”

”

Ne kemi vendosur të rritemi së bashku me gjithë bizneset, duke pasur parasysh që panairi Agrokos është një mundësi e artë për zhvillimin e bizneseve të reja, sikur ne në treg. E kemi pa si mundësi që të depërtojmë përmes panairit Agrokos.

Besimi Commerce

”

”

Në panair kemi ardhë me i prezantu produktet tona, dhe natyrisht, presim kontakte të reja me blerës të rinj.

Z. Lavdim Leka
Bio Go Healthy

”

”

Në panair kemi ardhur për të prezantuar brendin tonë – një brend shqiptar që prodhohet në vende të ndryshme të botës, sipas standardeve evropiane.

Znj. Emanuela Hykollari
Inda

”

”

Kemi pasur në plan të marrim pjesë në këtë panair që para dy ose tre vitesh, por menduam se ky është momenti i duhur. E shohim tregun e Kosovës dhe të Shqipërisë si një treg me potencial të madh, prandaj jemi këtu për të krijuar kontakte.

Z. Milos Mlitch
Cimbria

”

”

Panairi Agrokos është një mundësi e mirë për neve si fakultet, është një mundësi e mirë për studentët tanë që të takohen me biznese të ndryshme, t'i shkëmbejnë përvojat e tyre dhe ta kthejnë të gjithë anën teorike dhe përvojat e mësimit të tyre në anën praktike.

Znj. Fatime Rexhepi-Berisha
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë – UP

”

”

Ky panair është një mundësi shumë e mirë për neve si biznes që t'i prezantojmë produktet tona, por njëkohësisht të kemi kontakte edhe me biznese të tjera që janë këtu, duke përfaqësuar produktet e tyre dhe të krijojmë bashkëpunime edhe me ta.

Znj. Fitore Ukiqi
Gambini

”

”

Panairi Agrokos na mundëson bashkëpunim, prezantim sigurisht, na mundëson lidhje të ndryshme me distributorë apo partnerë të ndryshëm. Kjo është hera e tretë për ne që po marrim pjesë – në dy vitet e kaluar kemi krijuar bashkëpunime të mirëfillta.

Znj. Erblina Avdijaj
Bliff Organic

”

”

Arsyeja pse kemi ardhur në këtë panair është sepse këtu kemi mundësinë të krijojmë lidhje të reja me biznese vendore dhe të huaja. Qysh në mëngjes kemi krijuar kontakte të reja me shumë operatorë dhe shpresojmë që në të ardhmen të bashkëpunojmë me ta.

Z. Leonard Lollumi
Juniku SH.PK.

”

”

Në panair kemi vendosur t'i prezantojmë produktet tona në mënyrë që të krijojmë kontakte me klientelë të re, të njoftohemi me njerëz dhe konsumatorë, që më pas shpresojmë të bëhen klientët tanë në të ardhmen.

Z. Don Krasniqi
Kantina Zana

”

”

Nuk është hera e parë që marrim pjesë në panair, është disa herë që marrim pjesë në panaire të ndryshme dhe arsyeja është që t'ua tregojmë klientëve tanë nga afër produktet e reja që i kemi lansu këtë vit.

Z. Dervi Llukhaxhaj
Lajthiza

”

”

Nga ky panair presim të njihemi me investitorë, me kompani të ndryshme, me njerëz me të cilët mund të bashkëpunojmë në të ardhmen.

Z. Diellor Berisha
Liri

”

”

Vizitorëve kryesisht po u prezantojmë produktet tona, të cilat veçse kanë marrë titullin lider në tregun vendor. Po presim kontakte të reja dhe shumë vizitorë në mënyrë që të bëjmë prezantimin sa më mirë dhe të jemi sa më afër me klientët e produktit Farmisa.

Z. Blend Broqi
M&Silloi

”

”

Në këtë panair kemi prezantuar produkte që kryesisht i shërbejnë industrisë së prodhimit, të cilat përdoren për paketime, markime dhe për të përmbushur të gjitha standardet e kërkuara, sidomos për eksportin e produkteve të Kosovës. Presim të formojmë lidhje të reja biznesore, jo vetëm me vizitorët, por edhe me kompanitë pjesëmarrëse.


Z. Ilirjan Miftari
Solvit SH.PK.

”

STATISTIKA

AGROKOS & AGROTURIZËM 2025

Edicioni i 25-të i panairit dëshmoi edhe një herë rolin e tij kyç si platforma më e madhe e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në sektorin e agrobiznesit dhe turizmit rural.



• **164** Ekspozues
Kompani pjesëmarrëse

• **132**
Ekspozues
vendor

• **32**
Ekspozues
të huaj

• **26**
Kompani bashke
ekspozuese

Pjesëmarrje ndërkombëtare

Përfaqësues nga 10+ shtete,
përfshirë: Kosova, Shqipëria,
Maqedonia e Veriut, Mali i Zi,
Greqia, Koraci, Bullgaria, Turqia,
Slloveni, Germania, Italia, etj



Profili i vizitorëve dhe origjina e tyre

Panairi mirëpriti mijëra vizitorë nga Kosova dhe rajoni, mes të cilëve ishin përfaqësues të bizneseve, institucioneve publike, organizatave ndërkombëtare si dhe qytetarë të shumtë të interesuar, duke i dhënë eventit një karakter të fortë lokal dhe rajonal.





Sektorët që përfaqësojnë kompanitë ekspozuese në panairin AGROKOS dhe Agroturizëm

Prodhuar të
ushqimeve dhe
pijeve

Përpunues të
produkteve
bujqësore

Prodhuar të
makinerive dhe
pajisjeve bujqësore

Operatorë të turizmit
rural dhe agroturizmit

Ofrues të teknologjisë dhe
shërbimeve për bujqësi





PËRMBYLLJE

AGROKOS & AGROTURIZËM 2025 ishte më shumë se një panair, ishte një hapësirë bashkëpunimi, inovacioni dhe frymëzimi për të gjithë ata që besojnë në të ardhmen e bujqësisë dhe turizmit rural në Kosovë dhe rajon.

Ky edicion jubilar dëshmoi se kur puna, vizioni dhe përkushtimi bashkohen, krijohen mundësi të reja për zhvillim ekonomik, eksport dhe mirëqenie sociale.

Falë kontributit të të gjithë pjesëmarrësve si: ekspozuesve, vizitorëve, institucioneve dhe partnerëve të panairit, AGROKOS mbetet një histori suksesi që do të vazhdojë të shkruhet vit pas viti.



Shihemi ne edicionin e 26 të
AGROKOS & Turizem 2026
Panair i Ushqimit, Pijeve, Agrobiznesit dhe Agroturizmit

27 - 28 Maj 2026

Prishtinë - Kosovë

CEO - Congress and Event Organization

Mob: +383 44 629 916 | Mob: +383 46 444 420
Adresa: Rr. Emrush Miftari nr.14 - Velani, 10000 Prishtinë, Kosovë
info@ceokos.com | www.ceokos.com